20 VJET SUKSES UAMD

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2914/7 Prot.

Durrës, më 11.12.2025

# VENDIM

**Nr. 117, datë 11.12.2025**

**PËR**

**"PËRCILLET SHKRESË NR.2551 PROT., DATË 05.11.2025, NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS"**

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë";* të ligjit Nr. 8480, datë 27.05.1999 "*Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike";* në Statutin dhe në Rregulloren e UAMD-së; udhëzimi 27, datë 29.12.2017 të Ministrit të Arsimit "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë", shkresës së Rektorit nr.2551 prot., datë 05.11.2025, shkresës së Administratorit nr.2551/1 prot., datë 09.12.2025, Bordi i Administrimit,

**VENDOSI:**

1. Përcjelljen e shkresës së Rektorit nr.2551 prot., datë 05.11.2025 me objekt "Kërkesë", Njësisë së Auditimit të Brendshëm në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, për pikat si më poshtë:

   **Pika 6:** Të verifikohen të ardhurat e arkëtuara nga tarifat e studentëve për periudhën Janar- Tetor 2025 dhe të krahasohen me të ardhurat e planifikuara;

   **Pika 7:** Të verifikohen rastet e pagesave mujore të stalît administrativ, kur kanë rezultuar me mungesë në momentel e kontrolleve nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore. Të verifikohet nëse i është bërë ndalesë nga paga për ditët e munguara. Për ata që e kanë patur rast përsëritje, të verifikohet performanca në punë për rastet që kanë rezultuar me mungesa gjatë kontrolleve, si dhe çfarë masash janë marrë. Të verifikohet nëse është respektuar Kodi i Punës për periudhën Tetor 2024 - Tetor 2025. Të verifikohet nëse janë protokolluar procesverbalet e kontrolleve për prezencën në punë;

   **Pika 8:** Të verifikohet zbatimi i Vendimeve të Rektoratit, për plotësim nevojash me bazë materiale të stafit, sipas afateve të cakmara në vendimet përkatëse gjatë vitit 2025.

   **Pika 9:** Të verifikohet nëse janë kryer në afat pagesat për stafin akademik, ndilimës akademik dhe administrativ. për projette të ndryshme, udhëtime, dieta etj. nga Drejtoria e Shërbimeve Financiare.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
    - Njësia e Auditimit të Brendshëm

**KRYETAR I BORDIT TE ADMINISTRIMIT**
**Ada ALIAJ**